Procesverbal i mbledhjes datë 30.04.2026

Sot, në sallën e mbledhjeve të KB Devoll, u zhvillua mbledhja e rradhës sipas njoftimit të datës 24.04.2026.Të pranishëm në sallë:
Alfredi Gjata, Ilir Hoxha, Valbona Spaho, Oljana Çomka, Arsina Mazelliu, Kledi Cencolli, Oliver Mulla, Trifon Meraku, Lindita Cokani, Paola Spaho, Vladimir Kello, Imelda Cucka.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 1: **Miratimi i rendit të ditës**.
Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2: **Miratimi i procesverbalit** të dates 27.03.2026.
Hapet Votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 3 , Projekt-Vendim Nr.35 Datë 22.04.2026 , " Për miratimin e ndihmes ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per bllok ndihmën ekonomike për muajin Mars 2026.
Nuk ka diskutime
Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4, Projekt-Vendim Nr.36 Datë 22.04.2026 , " Për miratimin e ndihmës financiare për perballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi rezerve i bashkisë per qytetarët në nevojë."

Oliver Mulla: Ngre një pyetje pse është kjo shifër shpenzimesh për njërin nga të ndjerit?

Eduard Duro: Sepse ishte në azilin e Poliçanit dhe eshtë bërë transporti deri në Vidohovë.

Vladimir Kello: Unë kam një kërkesë: është ndarë nga jeta një mësues në mënyrë tragjike, sepse vetëm rruga që bënte duke marrë parasysh stresin që i shkaktohej, për mua puna e të ndjerit Z. Alban Bejleri ishte jashtë mase e vështirë dhe për mua është i rënë në detyrë.
Për mua, ata fëmijë duhet të ndihmohen dhe shpenzimet e varrimit të mbulohen nga bashkia.
Alfredi Gjata: Ne e kemi bërë si propozim, por nuk ishin dokumentet gati, kështu që e kemi lënë për mbledhjen tjetër.
Oliver Mulla: Të gjithë e dimë sa rrugë e vështirë ishte.
Trifon Meraku: Ne mbështesim propozimin e Vladimir Kellos, parimisht jemi të gjithë dakord për mbulimin e shpenzimeve të varrimit nga bashkia dhe ju falënderoj për dëshirën e mirë.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 5 , Projekt-Vendim Nr.37 Datë 22.04.2026 , "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 në nivel programi."

Bledi Diko: Sipas tabelës duket qe kemi rritje. Kjo është në të mirë të komunitetit, sepse përfaqëson rritjen e të ardhurave, në bazë te të ardhurave percaktohet dhe pjesa e tavaneve.
Hapet Votimi: 12 pro, 0 kundër , 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me pikën 6, Projekt-Vendim Nr.38 Datë 22.04.2026 "Për kalimin në pronesi te trojeve te dhena per gellime ndertimi nga bashkitë, ish komunat dhe ish këshillat e rretheve pas datës 10.08.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit 24/2012 "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij" dhe për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Devoll ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhjen e kontratës përpara noterit për shitjen e trojeve të dhëna për ndërtim."

Vladimir Kello : Nga viti 92' e në vazhdim derisa ishin në fuqi rrethet, akti përfundimtar për ndërtim ishte akti që lëshohej nga KRRT e rrethit. Për mua janë të vonuar këta qytetarë duhet ta kishin paguar më parë, shyqyr tani që do e paguajmë dhe ne.
Të gjithë qytetarët duhet të paguajnë sa më shpejt detyrimet që kanë për truallin që kanë. Pyetja ime është kjo ; Ka leje ndërtimi apo jo?

Eriksela Avdo: Jo te gjitha, por shumica po.

Hapet Votimi: 12 pro, 0 kundër , 0 abstenim.

Alfredi Gjata : Vazhdojmë me pikën 7,8, 9.....Projekt-Vendim Nr.39 Datë 22.04.2026 "Për miratimin e bashkëortakerisë nëpërmjet dhurimit të një pjese të kuotës nga shogeria me pergjegjesi te kufizuar DRITSOL Sh.P.K."
Projekt-Vendim Nr.40 Datë 22.04.2026 "Për miratimin e bashkeortakerise nepermjet dhurimit te nje pjese te kuotes nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar A-CO Sh.P.K."
Projekt-Vendim Nr.41 Date 22.04.2026 "Per miratimin e bashkëortakerisë nëpërmjet dhurimit të një pjese te kuotës nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ALBEDO SOLAR Sh.P.K."
..... janë bashkuar në 1 , i cili eshte Pv 42 Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për të negociuar me shoqëri të cilat kanë shprehur interes për ta bërë Bashkinë bashkëortake në shoqëritë e tyre.

Eduard Duro: Është bërë Pv , jane 3 propozime që janë bërë nga kompani të ndryshme.
Vlera minimale per ne është 25% .

Vladimir Kello: Gjithmonë kur bëhen këto ortakëri do mundohesh gjthm të kesh 41 me 59.

Eduard Duro: Janë investime te mëdha , që kerkojnë kredi.

Ilir Hoxha: Ky 25% a justifikon a shkon baraz me qirane?

Eduard Duro: Shkon 10 fish . Kjo është sipas plan bizneseve që kanë depozituar bizneset behet fjale për 3 parqe fotovoltaike , në 4 ngastra toke. 3 janë pronë bashkie dhe 1 pronë shteti për të cilën do aplikojmë për regjistrim.
Nuk mendoj që do kemi pengesa për sa i përket iniciativave që bashkia po merr.
Aksionet do te dhurohen nëpërmjet dhurimit të kuotave pasi kompanitë janë ShPk.
Shpresoj që bashkisë ti lemë një pasuri për të ardhmen dhe te prodhojmë vetë të ardhura.

Alfredi Gjata: Ky është në parim? Por kur kemi emra të përveçem , squhet me në parim, por keto shoqeri jane afruar. Unë do isha dakort që jo 3 por 13, edhe pse nuk paragjykoj keto firma as i njoh, por derisa e miratojme ne parim per mua eshte interesi publik dhe i bashkise. Ne duhet te autorizojme qe ti te negociosh me maximumin e mundshem qe mund te marrim.
Lindin dhe pyetje te tjera, keto firma kane kapital?

Eduard Duro: Këto firma janë të reja dhe kanë kapital fillestar.
Nëse arrijme ta realizojme , behet fjale per nje park energjitik per Bashkine rreth 30 megavat.
Qe nuk është pak.

Hapet Votimi: 12 pro , 0 kundër , 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Kemi nje kerkese per ngritje lapidari per deshmoret. *lexohet Kerkesa*

Eduard Duro: Ky lapidari do te jete per deshmoret e atdheut nga 1912 deri sot, per te gjithe deshmoret, policet e rënë ne detyrë etj.
Vladimir Kello: Herën e parë bëra një propozim për bustet.Nuk e bera pa qellim sepse ketu pronat e bashkisë e merrte koperativa , individi etj. Ashtu sic edhe dëshmorët tanë janë varrosur ne vendet fqinje.
Aty ku ka prona , te behet studimi urbanistik dhe te behet qyteti.
Trifon Meraku: Une kam bërë një kerkese per sa i perket pemeve qe ndodhen ne trotuarin e shkollës, te cilat ende nuk jane prerë
Eduard Duro: Ne na është komunikuar nga drejtoria e shkollës që ato s'përbëjnë asnjë problem, megjithatë do te marrim masa për prerjen e tyre duke qene se edhe trotuari është shumë i ngushtë.
Trifon Meraku: Tjetra , Kemi marre nje vendim per dhenie titulli Qytetar Nderi per Z.Ridvan Bode, a ka ndonjë problem qe nuk i është dhënë certefikata?
Eduard Duro: Ska asnje problem, por sipas ligjit per dhenien e titujve dhe certifikatave te nderir behen ne raste festas dhe eventesh kombetare.
Kete titull e jep kryetari i Bashkise .
Trifon meraku: cilen feste te presim?
Eduard Duro: Mund te behet per Kurban Bajram.
Alfredi Gjata: Ka disa kërkesa nga qytetaret , keta qe kane femijet ne kopesht, mundesisht te zgjatet orari deri ne 2 ose Bashkia te krijojë mundësinë për një kopësht me drekë.
Eduard Duro: Me drekë mirë do ishte por ka riskun e vetë dhe është pak e vështirë.
Ilir Hoxha: Drekën mund ta marrin dhe me vete por te paktën të shtyhet koha.
Eduard Duro: Bëjmë një ndryshim muajin tjeter dhe shtojmë 5-6 mësues after school. Të qëndrojnë fëmijët deri në orën 3-4.
Vladimir Kello: Unë jam befasuar ne FB , nuk e di si gjykohet, është një arritje e madhe e sociologëve të Bashkisë dhe psikologëve dhe komisariatit të Bilishtit , të cilët kapën një njeri të braktisur nga përgjegjësia.
Bëhet fjalë për Hysenin.
Të bëhet një dëgjesë , dhe mënyra si po veprohet nuk po i shërbehet qytetarit, por ai po stresohet.
Sociologet dhe psikoologet duhet të përdorin forma për ti rehabilituar njerzit.
Jam vërtet i indinjuar me këtë rast. Unë e kam të gjithën tek mënyra si e trajtuan.
Eduard Duro: Personi në fjalë nuk ishte arrestuar, përkundrazi ishte gjetur pa ndjenja ne Librazhd. Më vjen keq te them por persona me probleme të shëndetit mendor duhen patjetër të shoqërohen nga policia. Ne e sollem këtej per me shume kontroll a përkujdesje.

Nuk ka më diskutime.
Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Kostandina Braholli

Alfredi Gjata